



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 166P/prot.
5

Tiranë, më 24.10 2019

VENDIM

Nr. 48, datë 24.10.2019

Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në “Marrëdhënie Ndërkombëtare, në Fakultetin e Shkencave Sociale, UT

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3, pika 2, gërma b; neni 35, pika 1; neni 38, pika 1, gërma “dh”; neni 73; Udhëzimin e MASR-së Nr. 31, datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë” dhe Statutin e Univesitetit të Tiranës neni 31, gërmat f), j) dhe cc); si dhe në propozimin e Fakultetit të Shkencave Sociale me shkresat Nr. 368/3 Prot., datë 09.04.2019 dhe Nr. 368/7 Prot., datë 09.07.2019, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 24.10.2019;

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programit të studimit të ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, të Fakultetit të Shkencave Sociale, të UT-së sipas dokumentacionit bashkëngjitur.
2. Dokumentacioni i plotë të përcillet në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për miratim.



KRYETARI

PROF. DR. MYNYR KONI